



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 18, datë 10.03.2014**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PAGESËN  
NGA REZERVA MONETARE TË DËMEVE QË MBULOHEN NGA KONTRATAT E  
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”**

Në bazë dhe për zbatim nenit 14, paragrafët 3 dhe 20, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 13, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, si dhe nenit 104, paragrafi 3, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurimeve dhe risigurime”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Rregullores “Përcaktimin e rregullave për pagesën nga rezerva monetare të dëmeve që mbulohen nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Enkeleda SHEHI**

Në mungesë dhe me porosi,

**Enkela IDRIZI**  
**NËNKRYETAR**